



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 6674/5 Prot.

Lezhë, më 03/07/2025

V E N D I M

Nr. 278 .., datë 03/07 /2025

“PËR
MIRATIMIN E PAKETËS SË PLOTË NË KUADËR TË THIRRJES
SË SHTATË PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME NË PROGRAMIN
RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN
PERËNDIMOR (ReLOaD 2)”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.1 shkronja (b), Vendimi Nr. 393., datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”, VKB Nr. 211., datë 31.10.2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile” pika 2 “Të miratohet Metodologjia LOD për alokimin e fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile, të propozuar nga UNDP dhe të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë”, “Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë” Nr. Prot 17007 .., datë 22.09.2021, **VKB Nr. 99, datë 19/12/2024** “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2025”, **Urdhërit Nr. 265., datë 27/05/2025** “Për krijimin e grupit të punës për kryerjen e procedurave për hapjen e thirrjes së VII-të të programit ReLOaD të financuar nga Bashkia Lezhë”., **Procesverbal Nr. 1** me Nr 6674/2 Prot., datë 13/06/2025 “Për përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes 7-të të Programit Reload” **Proceverbalin Nr. 2** me Nr. 6674/3 Prot., datë 25.6.2025 “Për diskutimin e prioriteteve me OSHC-të për thirrjen e Shtatë të Programit ReLOaD2, financuar nga Bashkia Lezhë” dhe **Procesverbalin Nr. 3** me Nr. 6674/4 Prot., datë 01/07/2025 “Për miratimin e prioriteteve dhe paketës së plotë për Thirrjes se Shtatë të programit ReLOaD 2, financuar nga Bashkia Lezhë”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
V E N D O S I:

1. Miratimin e prioriteteve në kuadër të Thirrjes së Shtatë Publike për Projekt Propozime në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD 2).
2. Miratimin e paketës së plotë në kuadër të Thirrjes së Shtatë Publike për Projekt Propozime në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD2), si më poshtë:
 - Shtojca 6** Udhëzuesi;
 - Shtojca 7** Projekt Propozimi;
 - Shtojca 8** Buxheti;
 - Shtojca 9** Korniza Logjike;
 - Shtojca 10** Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë;
 - Shtojca 11** Formulari i identifikimit administrativ dhe financiar;
 - Shtojca 12** Deklarata për plotësimin e kriterëve;
 - Shtojca A** Deklarata e partneritetit;
 - Shtojca B** Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

